

VENDIM
Nr.318, datë 18.4.2020

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR LOTIN 3, ME OBJEKT “BLERJE BARNA
RIBAVIRIN 200 MG TABLETË/KAPSULË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 3, me objekt “Blerje barna Ribavirin 200 mg tabletë/kapsulë”, me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik “REJSI FARMA”, sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë, me objekt “Blerje barna kundër Coronavirus COVID-19, ndarë në 10 (dhjetë) lote (një bar një lot)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama